



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:912694

Datë: 15.02.2021

Numri i dokumentit: 01505645

Ac.nr.4551/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar i kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike të paditësit K... ..., ndërtesa ...Prishtinë, kundër të paditurit A.A.T nga Suhareka, Rr.”...” pa numër, për kompensimin e dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, C.nr.398/2018 të dt.02.07.2019, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurit A.A.T nga Suhareka, Rr.”...” pa numër, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, C.nr.398/2018 i dt.02.07.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K... ..., ndërtesa ...në Prishtinë. Detyrohet i padituri A.A.T nga Suhareka Rr.”...” pa numër, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 286.63 euro (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e tre cent) me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, nga data e nxjerrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive, si dhe taksat gjyqësore në shumë prej 20,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

## **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se: Paditësi ka parashtruar padi kundër të paditurit për kompensim të dëmit material të shkaktuar me veprën penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 320 i KPK-së, për të cilin i padituri është shpallur fajtor në procedurën penale me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekës me shenjen P.nr.426/2016 i dt.15.05.2017, i cili është i plotfuqishëm nga dt.07.06.2017, ndërsa paditësja ishte udhëzuar në kontest civil për realizimin e dëmit të shkaktuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendim me shenjë C.nr.398/2018 të dt.25.03.2019, e ka njoftuar të paditurin me të drejtën e parashtrimit të përgjigjes në padi, të cilin aktvendim i padituri e ka pranuar me dt.01.04.2019, por nuk ka parashtruar përgjigje në padi, kështu që gjykata e shkallës së parë duke konsideruar se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 150 të LPK-së, ka marr aktgjykimin për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes).

Këtë gjendje faktike të çështjes, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 150, dhe nenit 452 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se, gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës në këtë çështje kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 nën par. b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar drejtë e për të cilat Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës, kujdeset sipas detyrës zyrtare, konfrom dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin C.nr. 398/2018 të dt.25.03.2019, ia ka dërguar të paditurit, padinë për përgjigje, si dhe provat shkresore duke e njoftuar të paditurin, për pasojat ligjore në rast të mos veprimit sipas këtij aktvendimi. Ky aktvendim të paditurit, i ishte dorëzuar me datën 01.04.2019, i cili e ka pranuar aktvendimin, e kjo vërtetohet me flet kthesën e nënshkruar nga i padituri. Mirëpo, i padituri nuk kishte vepruar sipas urdhrit të gjykatës.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në bazë të kësaj gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka marrë aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes), duke vlerësuar se janë përmbush kërkesat ligjore nga neni 150.1 a), b), dhe c) të LPK-së, sepse i padituri nuk ka vepruar sipas detyrimit ligjor të marrë me aktvendimin e gjykatës për dhënien e përgjigjes në padi.

I padituri në ankesën e paraqitur, nuk e ka kontestuar faktin se i është dorëzuar padia me shkresa për përgjigje, por pretendon se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike pasi që, njehsorin e rrymës e kanë shkyqur punëtoret e K...-it dhe prapë në të njëjtën ditë e kanë kyqur dhe se është i pa punë dhe nuk ka mundësi materiale që të bëjë pagesën e kësaj shume, pasi që jeton bashkë me bashkëshorten the tre fëmijët e tyre, e që të ardhurat e vetme i kanë ndihmat sociale, e për këtë arsye kjo shumë e lartë për pagesë është barrë e rëndë për të paditurin, të cilit edhe mund ti keqësohet gjendja familjare e mbajtjes së familjes së tij, duke konsideruar që në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë, po ashtu ka zbatuar gabimisht dispozitat e të drejtës materiale.

Mirëpo, sipas Gjykatës së Apelit pretendimet e tilla të paditurit nuk janë të bazuara në situatën ekzistuese, sepse detyrimi për pagesën rezulton nga aktgjykimi penal ku i padituri është shpallë fajtor dhe është dënuar për dëmin që i njëjti ia ka shkaktuar të paditurës për shkak të

shfrytëzimit të energjisë elektrike, në mënyrë të pa autorizuar. Ndërsa gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin e atakuar për faktin se i padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi në afatin e caktuar nga gjykata lidhur me këtë rast.

Gjykata e Apelit, konstaton se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e atakuar e ka dhënë me respektimin e ligjit procedural, konstatimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe zbatimin e drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë kishte dhënë Aktvendimin e saj C.nr. 398/2018 të dt.25.03.2019, me të cilin të paditurit ia kishte dërguar padinë për përgjigje, më të gjitha shkresat si dhe provat tjera të bashkangjitura kopjet e të cilave gjenden në shkresa të lëndës. Ky aktvendim, tani të paditurit i ishte dorëzuar me datën 01.04.2019, duke u informuar njëkohësisht edhe për pasojat ligjore në rast se i padituri, nuk përgjigjet në padi brenda afatit të caktuar. I padituri edhe përkundër këtij paralajmërimi nuk ishte përgjigjur në padi, kështu që edhe sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm.

Me nenin 150 paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të LPK, është përcaktuar se: *“Në qoftë se i padituri, brenda fatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po qe se janë plotësuar këto kushte:*

- a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi;*
- b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi;*
- c) po që se faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”.*

Gjykata e Apelit, konstaton se në këtë rast janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 150 paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të LPK-së, për të vendosur si në dispozitivi e aktgjykimit të atakuar, me arsyetim se, të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi, si dhe të gjitha provat shkresore mbi të cilat bazohet themelësia e kërkesëpadisë. Po ashtu, themelësia e kërkesëpadisë në këtë rast rezulton nga faktet e treguar në padi. Këto fakte nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar pala paditëse.

Prandaj, pretendimet ankimore të paditurit janë të pathemelta, sepse gjykata e shkallës së parë pasi, drejt ka konstatuar gjendjen e çështjes dhe drejtë ka vlerësuar përmbushjen e kushteve ligjore të nenit 150 paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të LPK-së, nuk ka pasur për detyrë që të caktoi seancë për shqyrtimin kryesor të çështjes, por të vendos si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Me dispozitën ligjore të nenit 150, mos përgjigja në padi e të paditurit si dhe përmbushja e kushteve ligjore të parapara me këtë dispozitë ligjore, ka për pasojë ligjore dhënien e aktgjykimit për pa dëgjueshmëri. Fajësia e të paditurit lidhur me dëmin e shkaktuar në këtë rast ishte vërtetuar me Aktgjykim penal të formës së prerë me shenjë P.nr.426/2016 të dt.15.05.2017,i plotfuqishëm nga dt.07.06.2017, ku i padituri e kishte pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor dhe për të cilin është shpallu fajtor, me detaje të tjera si në shkresa të lëndës.

Andaj, pretendimet ankimore të të paditurit në këtë rast janë të pa themelta, sepse ai nuk dëshmoi se paditëses nuk i është shkaktuar dëm me fajin e tij, edhe pse e kishte barrën e provës.

Gjykata e Apelit vlerësoi se janë krijuar kushtet ligjore nga nenet 200 dhe 195 par.1 pika d) të LPK-së, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
Ac.nr.4551/2019, me dt.22.01.2021

**KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI**  
Gëzim Llulluni